



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI
PËR VENDE TË LIRA PUNE
PËR SEKRETARIATIN NË KUADËR TË VEPRIMTARISË SË MBAJTJES SË
SEKRETARIATIT TË “BOLOGNA FOLLOW UP GROUP” NGA REPUBLIKA
E SHQIPËRISË**

Bazuar në Vendimin nr. 1163, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Sekretariatit në kuadër të veprimtarisë së mbajtjes së Sekretariatit të “*Bologna Follow Up Group*” nga Republika e Shqipërisë”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) shpall thirrjen për vende të lira pune

Ju mund të aplikoni gjatë periudhës **20 janar - 29 janar 2021** për jo më shumë se dy pozicione pune, ndërmjet atyre të shpallur në këtë thirrje duke dërguar jetëshkrimin tuaj (CV) dhe një letër motivimi, në të cilën të shprehet qartë angazhimi dhe motivimi juaj për pozicionet përkatëse. Dokumentet e kërkuara - të nënshkruara - të dërgohen me postë në adresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në adresën: Rruga e Durrësit Nr. 23, AL 1001, Tiranë dhe në formë elektronike (pdf.) në adresën info@arsimi.gov.al

Hyrje:

Republika e Shqipërisë ka marrë të drejtën e mbajtjes së Sekretariatit të BFUG-së, ku Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) është përgjegjëse për organizimin e takimeve mbështetëse të një natyre teknike, administrative dhe menaxheriale gjatë viteve 2021-2024, duke përfunduar me organizimin e Konferencës së Ministrave të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), si dhe mbështetje për organizimin e takimeve të ndërmjetme përkatëse në Shqipëri në vitin 2024. Në të njëjtën kohë, Komisioni Evropian ka dhënë një grant mbështetës për këtë qëllim.

Qëllimi parësor i veprimtarisë së Sekretariatit është të sigurojë mbështetjen asnjëse për konsolidimin e mëtejshëm të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (ZEAL) nën autoritetin e “Bologna Follow Up Group” në vijim (BFUG) dhe të koordinojë veprimet që ndërmerren në rang ndërkombëtar me planin e punës së BFUG-së dhe veprimtarinë e Grupit shqiptar të punës në mbështetje të BFUG-së gjatë periudhës së mbajtjes së Sekretariatit nga Shqipëria.

MASR, duke marrë në konsideratë pamundësinë e mbulimit të të gjitha detyrave profesionale të kërkuara me personel të brendshëm, gjithashtu duke marrë parasysh fushën e specializuar të referimit, synon të përdorë mbështetjen e profesionistëve të specializuar për realizimin e aktiviteteve në lidhje me zbatimin e ndërhyrjeve të përmendura, duke ngritur dhe një strukturë të përkohshme organizative për Sekretariatit e BFUG-së, në bazë të Vendimit nr.1163, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Sekretariatit në kuadër të veprimtarisë së mbajtjes së Sekretariatit të Bologna Follow Up Group nga Republika e Shqipërisë”.

Koha e zbatimit, në bazë të procedurave të lartpërmendura, të pasojave institucionale dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË**

metodave organizative përkatëse, kërkon që mbështetja teknike të sigurohet në një kohë të shkurtër dhe me urgjencë maksimale. Prandaj, konsiderohet të fillohet kjo procedurë përzgjedhëse.

Profilat e kërkuara dhe kriteret:

Kjo thirrje për shprehje interesi, ka për qëllim dhënien e mundësisë për aplikim nga kandidatë që plotësojnë kriteret dhe shprehin interesin për veprimtarinë që do të zhvillojë Sekretariati i “Bologna Follow Up Group”. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet mbi bazën e kualifikimeve të secilit kandidat, të deklaruara në jetëshkrim (Curriculum Vitae CV) dhe në bazë të rezultateve nga intervista. Intervista njohëse do të synojë marrjen e informacionit mbi përvojën aktuale dhe profesionalizmit të pasqyruar në CV, si dhe motivimin dhe vullnetin për të fituar pozicionin e punës. Në intervistë do të ftohen kandidatë për çdo pozicion.

Kriteret e përgjithshme:

Për secilin pozicion të kërkuar përmes kësaj thirrjeje janë përcaktuar si më poshtë kriteret e përgjithshme me qëllim vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për:

1. Profili: Kryetar i Sekretariatit të BFUG-së:

Kryetari i Sekretariatit të BFUG-së do të jetë një ekspert në fushën e arsimit të lartë që do të garantojë drejtimin e pjesës teknike-koordinuese, referuar të gjithë iniciativës, koordinimit të përgjithshëm të punës së Sekretariatit të BFUG-së. Ndër të tjera do të kujdeset për aspektet që lidhen me marrëdhëniet me bashkëpunëtorët institucionalë dhe jo-institucionalë të përfshirë në të gjithë elementët e projektit lidhur me mbajtjen e Sekretariatit të BFUG-së nga Republika e Shqipërisë.

Kryetari i Sekretariatit duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të zotërojë të paktën diplomë të ciklit të dytë të studimeve ose diplomë të barasvlershme me të (diploma e përfutur për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njohur dhe njehsuar sipas legjisllacionit në fuqi).
- Të ketë të paktën 15 vite eksperiencë pune, nga ku 5 vite të jenë përvojë në administratë ose institucionet e arsimit të lartë.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë në pozicione drejtuese të institucioneve, strukturave apo projekte kombëtare ose ndërkombëtare.
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze ose të ketë përfunduar një program studimi në gjuhën angleze.

2. Profili profesional: Ekspert i nivelit të lartë (2 me kohë të plotë):

Eksperti i nivelit të lartë në fushën e arsimit të lartë do të garantojë mbështetje teknike-koordinuese dhe shkencore, referuar të gjithë iniciativës, koordinimit të përgjithshëm të punës së Sekretariatit të BFUG-së. Ndër të tjera do të kujdeset për aspektet që lidhen me marrëdhëniet me aktorët institucionalë dhe jo-institucionalë të përfshirë në të gjithë zinxhirët e projektit lidhur me Sekretariatit të BFUG-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË**

Eksperti i lartë duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të zotërojë të paktën diplomë të ciklit të dytë të studimeve ose diplomë të barasvlershme me të (diploma e përfitur për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njehsuar sipas legjislacionit në fuqi).
- Të paktën 10 vjet eksperiencë pune, nga ku 5 vite të ketë përvojë në fushën e arsimit të lartë.
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze ose të ketë përfunduar një program studimi në gjuhën angleze.

3. Profili profesional: Ekspertë Junior në fushën e arsimit të lartë (3 ekspertë me kohë të plotë):

Ekspertët do të kryejnë funksione mbështetëse gjatë gjithë periudhës së iniciativës, në hartimin e dokumenteve dhe në organizimin e veprimtarive të zyrës sipas detyrimeve që rrjedhin nga mbajtja e Sekretariatit të BFUG-së. Për më tepër, atyre do t'u kërkohet të sigurojnë mbështetje në administrimin dhe arkivimin e të gjitha dokumenteve operative të projektit.

Eksperti Junior duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të zotërojë të paktën diplomë të ciklit të dytë të studimeve ose diplomë të barasvlershme me të (diploma e përfitur për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njohur dhe njehsuar sipas legjislacionit në fuqi).
- Përvojë pune prej të paktën 3 vite, nga ku 1 vit të jetë eksperiencë në fushën e arsimit të lartë.
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze ose të ketë përfunduar një program studimi në gjuhën angleze.

4. Profili profesional: Asistent zyre:

Punonjësi do të kryejë funksione mbështetëse dhe ndihmëse të operacioneve administrative të sekretarisë, për Sekretariatit të BFUG-së.

Punonjësi duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të zotërojë të paktën diplomë të ciklit të parë të studimeve ose diplomë të barasvlershme me të (diploma e përfitur për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njohur dhe njehsuar sipas legjislacionit në fuqi).
- Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune.
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze ose të ketë përfunduar një program studimi në gjuhën angleze.

5. Profili profesional: 1 (një) Ekspert me kohë të plotë në fushën e medias dhe 1 (një) ekspert me kohë të pjesshme në fushën e teknologjisë së informacionit (IT):

Eksperti do të duhet të kryejë një funksion mbështetës në përpunimin dhe zbatimin e planit të komunikimit të Sekretariatit BFUG-së, gjithashtu përmes përdorimit të mjeteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

alternative të komunikimit, si dhe duke u kujdesur për mirëmbajtjen e mjeteve të Teknologjisë së Informacionit, postës elektronike dhe marrëdhënies me ofruesit e shërbimeve të lidhura.

Eksperti i medias duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të zotërojë të paktën diplomë të ciklit të dytë të studimeve ose diplomë të barasvlershme me të (diploma e përfituar për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njohur dhe njehsuar sipas legjislacionit në fuqi).
- Eksperiencë pune në fushën e medias dhe komunikacionit (të paktën 1 vit).
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze ose të ketë përfunduar një program studimi në gjuhën angleze.

Eksperti i IT duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të zotërojë të paktën diplomë të ciklit të dytë të studimeve ose diplomë të barasvlershme me të (diploma e përfituar për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njohur dhe njehsuar sipas legjislacionit në fuqi).
- Të paktën 1 vit eksperiencë pune;
- Eksperiencë pune në mirëmbajtjen e website;
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze ose të ketë përfunduar një program studimi në gjuhën angleze.

Për të gjitha kriteret e kërkuara në këtë njoftim, sigurohet një qasje e barabartë, duke respektuar barazinë gjinore, fetare, ideore, kulturore dhe çdo karakteristikë tjetër personale. Në këtë thirrje do të promovohet transparenca dhe etika në kryerjen e aktiviteteve nga profesionistët dhe ekspertët, të cilët duhet të respektojnë Kodin e Etikës dhe legjislacionin në fuqi.